



# Republika e Kosovës

## Republika Kosova - Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim  
Agencija Kosova za Akreditaciju  
Kosovo Accreditation Agency



Data: 15.07.2016

Ref.: 643/16

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.02/2013, datë 16.01.2013), Këshilli Shtetërorë i Cilësisë, në mbledhjen e 43-të, të mbajtur më 06 Korrik 2016, mori:

### V E N D I M

- I. Akreditohen programet e studimit të BPrAL Kolegji “Globus” për periudhën tri vjeçare, 1 tetor 2016 – 30 shtator 2019:
  - Biznes dhe Menaxhment, BA, 180 ECTS (me specializime: Menaxhment Gjeneral Internacional; Financa dhe Banka; Kontabilitet dhe Auditim), (maksimum 150 studentë për vit akademik), Prishtinë dhe Podujevë;
  - Biznes dhe Menaxhment, MA, 120 ECTS, (Menaxhment Gjeneral Internacional; Financa, Banka dhe Kontabilitet), (maksimum 200 studentë për vit akademik).
- II. Nuk akreditohet programi i studimit:
  - Menaxhment Internacional, MA, 60 ECTS (Menaxhment Gjeneral Internacional; Financa, Banka dhe Kontabilitet; Menaxhim i Institucioneve në Edukim)
- III. Kuotat e caktuar më sipër për regjistrim e studentëve në programet e studimit, vlejné nga viti akademik 2017/2018.
- IV. Obligohet BPrAL Kolegji “Globus” që deri me 1 tetor 2016 në Agjencinë e Kosovës për Akreditim ta dorëzoj planin e rekrutimit të stafit akademik, për vitin akademik 2016/2017, për arsyeje të pensionimit të mundshëm të stafit, apo për çfarëdo arsyeje tjetër.

- V. Obligohet BPrAL Kolegji “Globus” që deri me datë 1 tetor 2016 të dorëzoj në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (AKA) Planin e Implementimit të Rekomandimeve të dhëna në raportin final nga ekspertëve ndërkombëtar të akreditimit.

### A r s y e t i m i

BPrAL Kolegji “Globus” ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA), për akreditim të programeve të studimit me stafin akademik si në vijim:

Nr.	Programi i studimit	Niveli	ECTS	Bartësit e Programit
1	Biznes dhe Menaxhment	BA	180	Enver Krasniqi, Esat Derguti, Violeta Lajqi
2	Biznes dhe Menaxhment	MA	120	Mufail Salihu, Aida Yzeiri, Donika Dabishevc
3	Menaxhment Internacional	MA	60	Dukagjin Zeka, Etem Iseni, Kastriot Pehlivani

AKA ka organizuar vizitën në BPrAL Kolegji “Globus” më datë 20.06.2016, me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit me këtë përbërje: Prof. Dr. Volker Gehmlich dhe Prof. Dr. Patricia Kotnik. Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC) në mbledhjen e mbajtur me 06 Korrik 2016 ka shqyrtuar aplikacionin e BPrAL Kolegji “Globus”, dhe duke u bazuar në të gjeturat e ekspertëve të akreditimit gjatë realizimit të vizitës, dhe në rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportin final nga ekspertët e cekur më sipër, KSHC vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Në lidhje me programin e studimit Menaxhment Internacional, MA, 60 ECTS, raporti i ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit, numëron këto vërejtje të cilat kanë quar në mos dhënien e rekomandimit për akreditim:

Programi i studimit Menaxhment Internacional me 60 ECTS është propozuar të ofrohet me tri specializime. Sipas ekspertëve ky program i studimit nuk ka një bazë të mirë dhe se nuk mund të ofrohen tri specializime brenda një programi një vjeçar. Specializimet sipas ekspertëve janë prezantuar sikurse të ishin 3 programe të ndryshme Master ani pse institucioni nuk ka aplikuar në këtë formë. Në fakt, sipas ekspertëve, përshtatjet e lëndëve të këtij programi janë identike me specializimet e vitit të dytë të programit dy vjeçar Master. Sipas ekspertëve, programi master një vjeçar nuk ka profil të qartë dhe gjithashtu kërkesat për pranim të studentëve nuk janë të përshtatshme dhe nuk janë arsyetuar mirë. Ky program i studimit vë në dyshim ekspertët në lidhje me nivelin e programeve master në kuptim të përshtatjes me standardet ndërkombëtare, dhe në krahasim me Kornizën Kombëtare dhe Evropiane të Kualifikimeve.

**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi mund të paraqitet kërkesa për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 126, pika 2 a, të Ligjit mbi Procedurën Administrative nr. 02/L-28. Kërkesa për rishqyrtim të vendimit i dorëzohet këtij organi në afatin prej 30 ditëve siç është përcaktuar në nenin 130, pika 1 e Ligjit mbi Procedurën Administrative.

Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Vendimi iu dërgohet:

- BPrAL Kolegji "Globus"
- MASHT;
- Arkivit të AKA-së.

---

Prof. Asoc. Dr. Blerim Rexha  
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë